

ALBANIAN DIGITAL PRINTING SOLUTIONS & SERVICES Shpk
Raporti i Audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Albanian Digital Printing Solutions & Services shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albanian Digital Printing Solutions & Services shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

ILD 99 Audit shpk
Luan Kamberi
Partner



02 shkurt 2018

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	7,260,479	1,978,910
Llogari të arketueshme tregtare	5	24,164,932	29,059,685
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	167,952	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	324,142	172,495
Inventari	8	10,711,386	8,299,699
Shpenzime të shtyra	9	4,281,684	2,361,618
Total Aktive Afatshkurtra		46,910,575	41,872,407
Aktivitet afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	17,859,870	22,004,399
Aktive afatgjatë jomateriale	11	35,093	48,041
Total aktive afatgjatë		17,894,963	22,052,440
Total Aktive		64,805,538	63,924,847
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	1,710,689	978,744
Llogari të pagueshme tregtare	13	9,340,605	9,948,313
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	8,138,509	1,537,844
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	15	10,823	14,507
Detyrime tatimore	16	1,116,183	1,918,340
Të ardhurat e shtyra		-	5,738,982
Të tjera detyrime	17	16,363	16,363
Total Detyrime afatshkurtra		20,333,172	20,153,093
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	18	25,244	3,345,997
Total Detyrime afatgjatë		25,244	3,345,997
Totali i detyrimeve		20,358,416	23,499,090
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	19	100	100
Rezerva ligjore		10	10
Rezerva të tjera		26,944,997	23,773,986
Fitimi i ushtrimit		17,502,015	16,651,661
Total kapitali aksionar		44,447,122	40,425,757
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		64,805,538	63,924,847

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	99,426,419	89,659,385
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		(10,265)	(325,981)
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	512,642	112,067
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(58,714,014)	(48,667,550)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	22	(52,499,846)	(41,062,581)
2) Të tjera shpenzime	23	(6,214,168)	(7,604,969)
Shpenzime të personelit	24	(15,600,335)	(14,857,748)
1) Paga dhe shpërblime		(13,854,761)	(13,143,556)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shendetësore		(1,745,574)	(1,714,192)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10/11	(4,216,653)	(5,169,752)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(488)	(1,352)
Shpenzime financiare	26	(625,716)	(1,051,441)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme		(326,634)	(533,456)
2) Shpenzime të tjera financiare		(299,082)	(517,985)
Fitimi/humbja para tatimit		20,771,590	19,697,628
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(3,269,575)	(3,045,967)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(3,269,575)	(3,045,967)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë			-
Fitimi/humbja e vitit		17,502,015	16,651,661
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		17,502,015	16,651,661

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100	10	13,480,649	10,293,337	23,774,096
Efekt i ndryshimeve në politikat kontabël					
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016					
Fitimi / Humbja e vitit				16,651,661	16,651,661
Lëvizjet përmes kapitalit				(10,293,337)	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	100	10	23,773,986	16,651,661	40,425,757
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				17,502,015	17,502,015
Fitimi / Humbja e vitit				16,651,661	-
Lëvizjet përmes kapitalit				(16,651,661)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				(13,480,650)	(13,480,650)
Dividendë të paguar					44,447,122
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100	10	26,944,997	17,502,015	44,447,122

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e kështre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë më 29 Janar 2018:

Elvis Sula
Administrator

Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave



Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Shenime	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	17,502,015	16,651,661
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	12,948	(185,566)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	483,204	1,129,154
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	4,216,653	5,169,752
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	2,655,088	7,435,957
Rënie/(rritje) në inventarë	(2,411,687)	(881,333)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(1,035,072)	(22,125,762)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	21,423,149	7,193,863
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(59,175)	(190,514)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(59,175)	(190,514)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(2,588,807)	(11,080,615)
Dividendë të paguar	(13,480,650)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(16,069,457)	(11,080,615)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	5,294,517	(4,077,266)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	1,978,910	5,870,610
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(12,948)	185,566
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	7,260,479	1,978,910

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

“Albanian Digital Printing Solutions & Services” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Mars 2011 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100 Lek, i ndarë në 3 kuota.

Ortakët e shoqërisë janë :

- Albdesign PSP zotërues i 24.5% të kapitalit të shoqërisë;
- Wildermore Holdings zotërues i 24.5% të kapitalit të shoqërisë;
- Inform P.Lykos S.a Processing & Development of Printed Information System zotërues i 51% të kapitalit të shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje e shtypshkrimeve dixhitale dhe menaxhim i të gjitha llojeve të dokumenteve dhe shtypshkrimeve. Tregti e të gjitha produkteve të ngjashme dhe makinerive që lidhen me këtë lloj aktiviteti. Shtypshkrim dhe menaxhim i dokumenteve me elemente sigurie. Përfaqësim në Shqipëri i shoqërive të huaja me aktivitet të ngjashëm.

Selia e shoqërisë është në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Kashar, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte 17 punonjës (2016: 16 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë.

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paafësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/ALL	132.95	135.23
USD/ ALL	111.10	128.17

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20 %
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

a. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

b. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

c. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

d. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

e. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

f. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

g. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

h. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

i. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Mjete monetare në bankë	7,173,078	1,908,378
Llogari rrjedhëse	7,173,078	1,908,378
Mjete monetare në arkë	87,401	70,532
	7,260,479	1,978,910

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Klientë	24,164,932	29,059,685
	24,164,932	29,059,685

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te arkëtueshme tregtare nga Albdesign PSP	167,952	-
	167,952	-

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
TVSH e kreditueshme	76,969	-
Detyrime doganore	142,173	147,497
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	105,000	24,998
	324,142	172,495

8. Inventari

Gjendja e inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Lënde e parë dhe materiale	10,443,267	8,021,314
Mallra për rishitje	268,119	268,120
Produkt i gatshëm	-	10,265
	10,711,386	8,299,699

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime të periudhave të ardhme	4,281,684	2,361,618
	4,281,684	2,361,618

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Pajisje kompjuterike	Te tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	47,030,472	953,836	73,041	3,152,094	3,210,496	54,419,939
Shtesa				190,514		190,514
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	47,030,472	953,836	73,041	3,342,608	3,210,496	54,610,453
Shtesa				7,916	51,260	59,176
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	47,030,472	953,836	73,041	3,350,524	3,261,756	54,669,629
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	(24,289,652)	(317,943)	(20,195)	(1,750,077)	(1,071,382)	(27,449,249)
Amortizimi i vitit	(4,240,584)	(127,176)	(10,572)	(350,649)	(427,824)	(5,156,805)
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	(28,530,236)	(445,119)	(30,767)	(2,100,726)	(1,499,206)	(32,606,054)
Amortizimi i vitit	(3,430,908)	(101,748)	(8,460)	(311,787)	(350,802)	(4,203,705)
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	(31,961,144)	(546,867)	(39,227)	(2,412,513)	(1,850,008)	(36,809,759)
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	22,740,820	635,893	52,846	1,402,017	2,139,114	26,970,690
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	18,500,236	508,717	42,274	1,241,882	1,711,290	22,004,399
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	15,069,328	406,969	33,814	938,011	1,411,748	17,859,870

11. Aktive Afatgjata Jo Materiale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	86,346	86,346
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	86,346	86,346
Amortizimi		
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	38,305	38,305
Amortizimi i vitit	12,948	12,948
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	51,253	51,253
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2016	48,041	48,041
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2017	35,093	35,093

12. Hua aftashkurta

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Overdraft Raiffeisen Bank	13,659	978,744
Qira Financiare Raiffeisen Leasing	1,552,066	-
Qira Financiare Porsche Leasing	144,964	-
	1,710,689	978,744

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Furnitorë vendas	2,380,321	1,414,107
Furnitorë të huaj	6,960,284	8,534,206
	9,340,605	9,948,313

14. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Të pagueshme tregtare	8,138,509	1,537,844
	8,138,509	1,537,844

15. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Furnitorë për fatura të pa mbërritura	10,823	14,507
	10,823	14,507

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	218,285	243,002
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	102,785	112,219
Tatim në Burim	311,909	357,324
Tatim fitimi	483,204	1,129,154
TVSH për t'u paguar	-	76,641
	1,116,183	1,918,340

17. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Të tjera detyrime	16,363	16,363
	16,363	16,363

18. Hua afatgjata

Huatë afatgjata detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Qira Financiare Raiffeisen Leasing	-	3,036,381
Qira Financiare Porsche Leasing	25,244	309,616
	25,244	3,345,997

19. Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë "Albanian Digital Printing Solutions & Services" sh.p.k. është 100 Lekë, i ndarë në 3 kuota.

Kapitali i shoqërisë nuk ka ndryshuar në vlerë por ka pësuar ndryshime në pronësinë e tij.

Me vendimin datë 23.03.2017 është miratuar shitja e 24.5 % të kuotave të kapitalit që zoteron Z, Elvis Sula tek ortakët e ri Shoqëria "Albdesign PSP shpk" sipas kontratës për blerje kuotash datë 20.04.2017.

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e produktit të vetë	87,986,928	71,815,142
Të ardhura nga shitja e mallrave	512,896	2,046,223
Të ardhura nga shërbimet	10,926,595	15,798,020
	99,426,419	89,659,385

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017
Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	93,444,784
Ndryshimi i gjendjes së parapagimeve	5,682,553
Zbritje nga shitjet për arkëtim në avancë	299,082
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	99,426,419
Shitje produkte të gatshme	87,986,928
Shitje mallrash	512,896
Shërbime	10,926,595
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	99,426,419
Të ardhurat nga interesat	
Fitim nga këmbimet valutore	805,551
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Fitimit	100,231,970

21. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Fitime nga këmbim të valutore	805,552	476,385
Humbje nga këmbimet valutore	(292,910)	(364,318)
	512,642	112,067

22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Kosto e materialeve të para	29,651,501	22,613,085
Kosto e materialeve të ambalazhimit	650,050	803,648
Pjesë këmbimi	3,726,484	2,060,417
Materiale të tjera ndihmëse	82,423	18,661
Kosto e mallrave të shitur	377,820	1,485,703
Nënkotaktorë	11,470,676	8,770,165
Mirëmbajtje dhe riparime makineritë dhe fabrika	970,974	394,163
Qira	3,465,671	3,549,845
Prime sigurimi	81,233	121,873
Energji elektrike	855,806	858,349
Shërbime nga të tretë	69,016	59,751
IT Servis	1,098,192	326,921
	52,499,846	41,062,581

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Mirëmbajtje dhe riparime	313,578	902,556
Shpenzime për licence software, konfigurim , setup	1,225,170	-
Shpenzime administrative dhe noteriale	293,498	69,223
Konsulenca ekonomike dhe juridike	2,257,954	3,482,766
Shërbime nga të tretë	258,088	502,498
Blerje të ndryshme, kancelari etj	127,334	760,162
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	330,327	423,613
Komisione bankare	297,197	275,180
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	15,536	-
Dhurata	151,600	-
Taksa të ndryshme	199,098	198,798
Kosto udhëtimi dhe akomodimi tekniket	39,124	59,782
Siguracione	53,727	15,979
Shpenzime për pritje	14,550	35,555
Shpenzime pjesëmarrje në tender	-	507,490
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	637,387	371,367
	6,214,168	7,604,969

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Shpenzime per paga	13,842,291	13,132,614
Shpenzime per sigurime shoq e shënd	1,745,574	1,714,192
Shpenzime të tjera për punonjësit	12,470	10,942
	15,600,335	14,857,748

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Gjoka dhe penalitete	488	1,352
	488	1,352

26. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Shpenzime për interesa	(326,634)	(533,456)
Zbritje nga shitjet për arketim në avancë	(299,082)	(517,985)
	(625,716)	(1,051,441)

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për Vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	20,771,590	19,697,628
Shpenzime të panjohura të tjera (si me poshtë)	1,025,576	608,818
Shpenzime pritje & percjellje, Dhurata	151,600	-
Penalitet, gjoka e dëmshpërblime	488	1,350
Shpenzime të tjera	873,488	607,468
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	21,797,166	20,306,446
<i>Tatim fitimi @15%</i>	3,269,575	3,045,967

28. Transaksionet me palët e lidhura.

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
Inform P.Lykos SA	3,826,103	1,537,844
Albdesign PSP	4,312,406	-
	<u>8,138,509</u>	<u>1,537,844</u>
Të arketueshme nga palët e lidhura		
Albdesign PSP	167,952	-
	<u>167,952</u>	<u>-</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
Albdesign PSP	2,040,648	-
	<u>2,040,648</u>	<u>-</u>
Blerje nga palët e lidhura		
Inform P.Lykos SA	13,208,178	24,385,457
S.C. INFORM LYKOS S.A.	1,207,151	
Albdesign PSP	15,800,117	
	<u>30,215,446</u>	<u>24,385,457</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

29. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2017 shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

30. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.